

INTERVISTË ME VAHIDE HOXHËN

Prishtinë | Shkurt 2013

Kohëzgjatja: 35 minuta

Të pranishëm:

1. Vahide Hoxha (E intervistuar)
2. Antigona Qena Kaçaniku (Intervistuesja)
3. Lulzim Kryeziu (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Narracioni: Antigona Qena Kaçaniku

Çdo kohë ka njerëzit e vetë, ka rininë, idealet edhe ambiciet e veta. Çdo kohë ka gëzimet dhe dhembjet, ndoshta nga një distancë kohore mund edhe të mos e pëlqejmë atë kohë, por po e hoqëm një gur nga ky mozaiku i historisë tonë do t'rrënohet tërësisht.

Sonte kuvendojmë me një zonjë e cila ishte dëshmitare, protagoniste e jetës sonë në këtë nënqiell.

Në këtë truall fryn shumë erëra e furtuna, por kjo ishte edhe puhiza pranverore që i dha vlerë e bukuri punës e krijimtarisë. Në luftë me kohën, zakonet dhe paragjykimet, ishin femrat tona që i bënë ballë realitetit me dëshirë të zjarrtë që të ndryshojnë atë, jo për veten sa për fëmijtë e gjeneratat që do të vijnë. Kishin në vete guximin e vullnetin për ta ndryshuar rrjedhën e reve në këtë nënqiell, ishin të parat që donin të pasuroheshin me dijeni, që donin ta ndihmonin të drejtën, që donin të lenin gjurmë dhe të krijonin e trasonin rrugë për gjeneratat e reja, për një ardhmëri më të bukur. Prandaj, nuk e meritojnë harresën.

Në një ditë vjeshte kur gjethet i thonin lamtumirë verës përcëlluse, trokitëm në derën e një gruaje. E kishim të qartë se po hapim një botë të pasur kujtimesh. Një zemër që troket ende me ritmin e melodisë së harruar.

Antigona Qena Kaçaniku: Në emisionin “Pa Skenar”, ne zakonisht fillojmë nga fillimi i hershëm. Edhe te ju dëshirojmë meqë historia juaj osht’ aq e pasun... jetësore. Dëshirojmë t’fillojmë nga familja juaj, prindët e juaj, cila familje është kjo në Prizren, apo...?

Vahide Hoxha: Antigona edhe une po ju falem’nderoj që keni ardhë, megjithëse nuk kam fort dëshirë me dalë në televizor edhe nuk jom shty asnihere me dalë (buzëqeshë). Kështu që, gjithmonë kam nejtë mrapa pak. Por, megjithatë e falem’nderoj... kjo do t’metet një lloj historie, një pjesë e historisë t’jetës sime.

Antigona Qena Kaçaniku: Me kënaqësi po e bëjmë këtë emision.

Vahide Hoxha: Une kam lindë në Prizren në familjen Sadif e Xhemajl Kabashit. Këta dytë i kam pasë prindët e mi. Nana ka rrjedhë prej një familjeje mjaft të pasun. Baba është prej familjes intelektualëve. Ai kohën ma t’madhe t’jetës e ka kalu në Selanik edhe n’Instamboll. Në Instamboll... në Selanik ka fillu fakultetin, në Instamboll ka vazhdu atje. Meqenëse baba i... gjyshi im ka punu në administratën turke, por ka qenë edhe deputet i Turqisë, kështu që ka vdekë si deputet por familjen e ka majtë në Prizren. Shumë

interesant është, s'ka mujtë me spjegu edhe vetë çka ka qenë arsyeja ai me metë n'Turqi e familja në Prizren.

Djali edhe dy vajzat që i ka pasë, grunë në Prizren, e ai në Turqi. Kështu që, herën e fundit që ka ardhë në Prizren ka qenë viti 1928.

Antigona Qena Kaçaniku: E ju sa fmi jeni?

Vahide Hoxha: Tri motra edhe dy vllazën. Motra jeme, Rabija ka qenë prej nxanëve t'para n'gjimnazin e Prizrenit. Ajo në vitin 1941 ka kry Maturën e Madhe, jo t'Voglën, ndërsa une Maturën e Vogël. Te na shkollimi n'atë kohë ka qenë shkolla fillore – katër klasë; deri n'semi-Maturë – katër klasë gjimnazi; pas semimaturës përsëri katër klasë deri në Maturë.

Antigona Qena Kaçaniku: Keni qenë shumë t'pakta femna në atë kohë në shkollë.

Vahide Hoxha: Jo shumë pakta, por neve dy motra edhe një vajzë, Jëlldëz Gjoni ka qenë, por ajo nuk vazhdoi, në semi-maturë e la. Rabija vazhdoi regjistroi Fakultetin e Farmacisë në Bolonjë të Italisë. Une vazhdova shkollimin n'Shkodër. Kështu që, u shpërndamë. Herën e parë dulëm prej shpisë, nuk ishte lehtë me dalë prej shpisë. Kur jam kthyer atë ditë prej shkollës që kam mrrë deri te ajo rruga afër Prizrenit ka qenë krejt me duda. Ajo, diçka nifar mërzi e madhe, herë gëzim e herë mërzi më kapi.

Antigona Qena Kaçaniku: Sa vjet ishit aty?

Vahide Hoxha: Dy vjet, dy vjet.

Antigona Qena Kaçaniku: Dhe ajo ishte shkollë për...?

Vahide Hoxha: Ajo ka qenë... për mësuse. Si shkollë pedagogjike ka qenë. Në Shkodër ka qenë gjimnazi tetë vjeçar. E gjimnazi klasik, shumë i përmendun ai gjimnazi i Shkodrës. Afër gjimnazit ka qenë një objekt, ngjitur gjimnazit, një objekt ku msojshin vetëm femnat. Une kam qenë e vendosun në internatin "Donika Kastrioti" quhej emni. Kemi qenë një 60 vajza prej krejt Shqipërisë.

Antigona Qena Kaçaniku: A kishte ndonjë kosovare tjetër femër?

Vahide Hoxha: Eh prej kosovarëve tjera aty ka qenë Drita Dobroshi. Vajzat e Mitrovicës kanë qenë në Tiranë. Neve... të Prizrenit kemi qenë në Shkodër.

Antigona Qena Kaçaniku: Dhe në Shkodër ishte koha e viteve të para luftës?

Vahide Hoxha: Po n'Shkodër kam qenë në vitin 1942-shin, '43-shin. Në '43-shin, në Shkodër ka qenë e organizime Lëvizja Anti-Fashiste. Edhe une e Drita i jemi bashku Lëvizjes Anti-Fashiste edhe n'atë shkollën tonë e bamë një demonstratë t'madhe... jo masë pari e bamë demonstratën në konvikt natën. Këmbë kangë patriotike, krejt n'oborr këmbë e karshi [përballë] nesh, policia ka qenë. Kah ora 12 u hapën dyert e hyni policia, na rrethoi edhe na detyroi me hy nëpër dhoma. Neve hymë nëpër dhoma, por vazhdum këmbë përsëri, por n'dhomë kemi qenë. Domethënë aty kemi bërë demonstratën e parë.

Pastaj demonstratën e dytë krejt shkolla, jo vetëm neve internatistat, por krejt femnat e asaj shkollës që kemi qenë, bamë një demonstratë n'obrrin e shkollës, kërkim që të ndërrohet drejtoresha. Drejtoresha ishte italiane, lyposhim neve me qenë një drejtor shqiptar. E bamë... bukur zhurmë t'madhe bamë neve.

Por ajo zhurmë na kushtoi, na mbyllën shkollën, na mbyllën konviktin edhe na qitën jashtë (qeshë). Kështu ishte situata!

Unë u ktheva në Prizren por për me mujtë me vazhdu tashti n'klasën tjetër, asht dashtë diku me u regjistru. Në Prizren nuk kishte, por ka qenë Shkolla Normale këtu në Prishtinë. Edhe erdha në Prishtinë, vazhdova mësimet në Prishtinë. Edhe në Prishtinë s'mujta me nejtë si duket rahat... s'e di çka ishte puna (qeshë). Para se me kry vitin shkollor, drejtori më thirri tha "S'mundesh me nejtë ma tej në shkollë". Edhe lexun ato deklaratat, një letër që përjashtohet nga shkolla.

Antigona Qena Kaçaniku: Pse?

Vahide Hoxha: Pasi jam në Lëvizjen Anti-Fashiste. Me t'kallxu t'drejtën Antigona [i drejtohet intervistueses], mu m'ka ardhë keq se u përjashtova andej... s'po muj me kry shkollën. Bukur me frikë kam shku në shpi {ngre supet}. Sado kudo isha frikë mos po m'bërtasin e diçka... Por, si duket e kuptun që s'kanë pasë çka me ba. Nji gjysëvjeter me maturën meta pa e kry të cilën e kryva privatisht pastaj.

Antigona Qena Kaçaniku: Si u njoftë me Fadilin?

Vahide Hoxha: Si aktiviste e rinisë anti-fashiste të Prizrenit, masi Prizreni u shliu prej okupatorit gjerman, po e theksoj kështu. Prizreni asht' liru me 17 nëntor. Me 18 nëntor, Xhavit Nimani m'thirri mu edhe disa shokë tjerë edhe na caktoi që t'shkojmë n'Gjakovë në konferencën e rinisë krahinore të Kosovës, që mahet rinia për krejt Kosovën. Konferenca për krejt Kosovën ku kanë marrë pjesë edhe ata partizanë që kanë qenë edhe neve prej mrpavisë. Neve që kemi punu në mrpavi quheshim "prej mrpavisë". Edhe shkova në konferencë bashkë me nja katër shokë të Prizrenit- shqiptarë. Por, para se me shku, kur dola në shatërvan une po shof serbët, rinia serbe, femnat e mashkujt e kanë vu ato shajkaqet e serbëve, ushtrisë së tyre. Une kur i pash ça paskan vnu, ej du... do t'nisem për në Gjakovë, shkova qaty... erdh rasisht ka qenë nji qeleshe¹, qeleshen që e bante, shkova morra një qeleshe e qita kresë [kokës] edhe u nisa për në Gjakovë. Kështu që me qeleshe e kam nji fotografi që kam dalë në Gjakovë.

Konferenca filloi, fillun përshëndetjet. Në sallë kanë qenë nja 200 vetë aty. Në sallë hyni komandanti, thanë "Po vjen komandanti!" U çumë të gjithë në kamë e shuplakat e të tjera... unë komandantin s'e kam pa. E kam ditë se asht komandant Fadil Hoxha, po kush asht' nuk e kam ditë. Mas përshëndetjes përsëri vazhdoi rrugën ashtu si ushtar edhe shkoi. Por, organizatorët e rinisë, e konferencës na lajmrinë që do t'mahet nji ballo në mramje për me argëtu ata delegatët e konferencës. Edhe une shkova, u ula me nji shoqe temen asht prej Prizrenit. Kur filloi muzika erdh komandanti, u afriu edhe asaj shoqes teme po i thotë "A po lejon qi ta marrë une këtë shoqen tande për me kcy?" Une s'kom ditë me kcy more, s'kom kcy asnjihere (qeshë), rashë në situatë bukur t'vështirë a din. Hajde u çova, por kërkova falje thashë, "Më falni!" edhe kështu, "Më falni se une nuk di me kcy, nuk di!" Ai më tha Fadili, "Po edhe une nuk di bash mirë, mësojmë bashkë" qështu (qeshë)...

Vazhdumë e luftëm e kcy më, neve çka kcy më, qikjo asht takimi i parë me Fadilin. Ma vonë më ka interesu, qysh mbrijti ai me ardhë te une, kurrë s'më ka pa hiç asnjihere e tjera... Por, në kryesi ka qenë nji shok Ramdan Vraniqi ka qenë edhe Mita Mirkoviqi. Mita Mirkoviqi ma vonë ka qenë ministër i arsimit, shumë i mirë ka qenë sa i përket asaj a din, se ka turlifar njerëz. Mita Mirkoviqi kishte thanë, "Kqyre Fadil, shko

¹ Kapelë, kësulë e bardhë tradicionale e punuar prej leshit, që dallon prej rajonit në rajon.

kqyre në mes të delegatëve”, se unë e përshëndeta n’konferencë, hypa atje naltë. I tregova si ka punu rinia antifashiste e femnave në Prizren edhe urova konferencën e qaq. Qaq ishte! Edhe u ktheva. Ai i paska tregu, paska thanë “Kqyre Fadil, se asht një vajzë aty prej Prizrenit që ka përshëndetë konferencën. Shko kqyre i ka do flokë kaçurrela e tjera, shko kqyre gjeje ku asht”. Ka pytë, asht interesu mandej kush jam edhe qështu dalëngadalë u njofta me to edhe u bashkova, në ‘45-tën për vitin e ri, une erdha në Prishtinë edhe u bashkova. U takova me Fadilin, por nuk nejta, u ktheva përsëri në Prizren deri n’mars punova atje. Jo vetëm n’Prizren, por punova në Suharekë e në Serbisë katundet, e andej e andej. Edhe pastaj u ktheva. Ato kushtet kanë qenë shumë t’vështira, shumë t’vështira.

Antigona Qena Kaçaniku: Dhe tash vjen martesë, ju bashkoheni edhe ku jetoni mas pari n’Prishtinë?

Vahide Hoxha: Unë bashkohem me Fadilin n’mars vitin 1945, po jetojmë në Divizion ku ka qenë ushtria qitu ku asht Muzeumi tashti. Qaty nalt katin e dytë {tregon me dorë} kemi pas një dhomë që shiqonte andej. Nji dhomë e vogël, sa gjysa e qisaj {tregon me dorë dhomën ku gjinden}, si dhomat e zyreve atje qi jonë. Dy kreveta t’hekrit, e do çarshafa t’vjetra, e nji jorgan t’vjetër, nji legen, e nji send për ujë... kantë për ujë – qikjo ka qenë jeta jonë në fillim. N’fund t’majit Shtabi Operativ ka kalu në Pejë, e ka lëshu. Komiteti Krahinor ka metë në Prizren, e Shtabi Operativ ka shku në Pejë, e Prishtinën e kemi lëshu. Deri sa kam qenë në Prishtinë përsëri kam punu’ me rininë, me gra, organizojshim grupe të ndryshme e tjera.

Para se me kalu në Pejë, deri sa kam qenë në Prizren kapërceva pak aktivitetin tim, jo për shkak timin, por për shkak atyne grave të cilat kanë punu. E organizata e grave ka qenë shumë aktive, por situatën e kemi pasë shumë të vështirë. Kërkush nuk do të beson në këtë kohë, prandaj historinë kur shkrunë njeri, duhet me kqyrë edhe kohën edhe situatën se si është.

Ka qenë shumë e vështirë, mungonte, çdo gja ka mungu. Buka mungonte, veshjet mungonte, gjithçka mungonte. Kujdesin ma t’madh kemi pasë dhanë ngritjes kulturore të femrave. Arsimimin mas pari. Fillumë e çelëm grupe antifashiste, kurset antifashiste. Pos kurseve analfabetike nëpër fshatra kemi organizu kurse t’amvisnisë, kurse t’higjienës. Edhe jo vetëm kujdes për fmi, por edhe agitimi që t’çojnë fëmijtë n’shkolla, mos t’i lëjnë fëmijtë pa shkollë. Nuk besoj që dikush do t’kishte besu’që qajo organizatë e Frontit të Grusë Antifashiste e ka qitë fletushkën e vet, buletinin e vet.

Une e kam numrin e parë t’buletinit, e kam. Po m’vjen keq që s’i kam numrat tjerë. Por numrin e parë t’buletinit e kam, e kur shkrunë për dy femna, njëna ka qenë që ka hekë çarshafin [hixhab] edhe asht’ aktiviste, po tjetra ka qenë mësuse e amvisnisë, ajo ka qenë çika e axhës time. Edhe neve kemi shkrujtë, Antigona po m’vjen keq edhe me thanë kam harru që kisha qenë kryeredaktore e atij buletin q’i s’kam pas lidhje me shtyp, po diqysh e kemi shty. Unë jam shumë e singertë, s’muj me zbukuru sendet (qeshë), s’muj me zbukuru gjanat. Por, e kemi revistën, buletinin e grave n’atë kohë! Asht’ viti po m’duket fillimi i ‘46-tës.

Antigona Qena Kaçaniku: N’Prizren çdo gja fillon, edhe radio edhe teatri edhe gazeta...

Vahide Hoxha: Edhe neve femnat e para kemi revistën tonë.

Antigona Qena Kaçaniku: Këto dëshirat e juja që t’filloni dhe të punoni, prej rinisë keni pasë një lloj kësi lloj ambicie, vullneti edhe ideale që femna të jetë më përparimtare, që femna të shprehet më lirshëm. Kjo ju ka vazhdu gjithë jetën m’duket?

Vahide Hoxha: Po, gjithë jetën! Por këtë liri që kam punu unë, une i jam bashku Lëvizjes, prej familjes teme une i jam bashku Lëvizjes, por që t’jemi t’lira e tjera, duhet me ju falemnderu prindëve t’mi – babës i cili na ka mundësu që t’mos veshin çarshafin. Jemi shkollu edhe na ka përcjellë, na ka palu librat, përcjellë në shkollë. Qajo nana jeme edhe me çarshaf që ka qenë, i ka përcjellë fëmijtë e vet në shkollë. Ajo nuk ka ditë me shkrujtë, por ka qenë me shpirt përparimtare. Se ky ka kry fakulltetin baba, nuk asht’ problem atij... bile e mara do t’kish me qenë me na pas shti...

Por kanë qenë ajo familja krejt ka qenë përparimtare se edhe motrat e veta, motrat që i ka baba, kanë kry shkollën e mesme Ruzhdisë², arabisht e ka kry n’atë kohë. Arabisht se s’ka pas n’atë kohë... por e kanë kry. Kanë dijtë me shkujtë, kanë dijtë me lexu’, lujshin letra, kshtuqi kemi qenë një familje pak ma e arsimume.

Antigona Qena Kaçaniku: I keni fmitë, Sharrin lindë menjihere mas luftës.

Vahide Hoxha: Sharri lindë në Prizren në 10 dhjetor të ‘45-tës, pa pasë gjanat elementare për fëmi, pa pelena, pa ujë, pa koritë. Por edhe neve në shpi ku kemi banu pos mureve t’shpisë, s’kemi pasë sende por vullneti dhe rinia e ka përballu ato gjana. N’shtator t’46-tës jemi në Prishtinë se kalon... Komiteti Krahinor, qeveria kalon në Prishtinë. Vendosemi përsëri në një shpi qi e ka gjetë ai Këshilli për vendosjen e nëpunësve e tjera, se kërkush prej tyre s’ka pas shpija. Kërkush, hiç! Krejt proleterë! (qeshë). Kështu që ka qenë një shpi e ulët, nuk ka qenë shpi e keqe, normale. S’kemi pasë kushte, s’kemi pasë as sende tjera por kemi qenë të kënaqur me aq.

Unë vazhdova punën këtu në Konferencën e Grusë Antifashiste, aty vazhdova si anëtare e Sekretariatit, anëtare e Këshillit. N’atë kohë ka qenë Bije Vokshi kryetare. Unë vazhdova aty deri n’vitin 1949. Deri atëhere qikjo organizatë ka qitë edhe një fletushkë tjetër, “Agimi” quhet, por ate nuk e kam. S’e di ku ka metë “Agimi”. E aty po e di që kam qenë kryeredaktore e “Agimit”, por po m’vjen keq që s’kom asnjë kopje edhe me pa barëm çka kom ba. Nojsend çka kam punu (qeshë).

Në ‘49-tën Fadili shkoi në Shkollën e Naltë Politike në Beograd. Une iu bashkova atij edhe u bashkëvendosëm edhe regjistrova une qat’ Shkollën Pedagogjike, dy vjet. Dy vjet me shpresë që e kryj edhe kthehem s’bashku përsëri. Sharrin e vendosa në një çerdhe atje n’Beograd, Fadili shkonte në punë edhe aty kam hjekë mjaft. Djali i vogël e çojsha në çerdhe, Beogradi nuk asht afër si Prishtina. Në një anë çerdhja, n’anën tjetër ajo Shkolla e Naltë Pedagogjike. Nejse une e kryva, me kohë e kryva shkollën, mirëpo me shpresë që po kthehem, por Fadilin e nalën edhe katër vjet n’Beograd. Une regjistrova Fakultetin edhe e kryva.

Antigona Qena Kaçaniku: E historisë?

Vahide Hoxha: E historisë. Lindi Lulja, lindi në Beograd. Më lindi edhe Leka në Beograd. Aktivitetin shoqnor nuk kam ndërpre, hiç! Por pesë vjet nuk punova, pas pesë vjetëve e pash që duhet me hy në punë. Jo vetëm që s’kisha dëshirë me nejtë në shpi, por ishte edhe çashtje materiale ishte. Neve t’ardhuna tjera s’kemi pasë, as shpi s’kemi pasë, as dyqan s’kemi pasë, as tokë s’kemi pasë, asnjë sen’ s’kemi pasë, por kemi qëndru shumë mirë, edhe po m’vjen mirë që e kemi kalu një jetë shumë t’mirë në harmoni me Fadilin me fëmijtë.

² E intervistuar e ka fjalën për shkollën e mesme Ryzhdije (*rüşhdiye*)– shkollë e mesme fetare e cila u hap në vitin 1874 në Prizren.

Antigona Qena Kaçaniku: I kam hallat që kanë qenë në Normale dhe ju mbajnë në mend si profesoreshë dhe me shumë respekt dhe dashuni.

Vahide Hoxha: Në Shkollë Normale diçka shumë mirë më kanë pranuar ata nxënësit, s'ë di pse kaq shumë (buzëqeshë).

Antigona Qena Kaçaniku: Ke qenë më afërt me ta?

Vahide Hoxha: E afërt kam qenë me ta, asht e vërtetë. Jam përpjekë me i ndihmu, një pjesë t'fëmive, jo një pjesë... pjesa më e madhe kanë qenë prej fshatrave edhe ekonomisht dobët kanë qenë. Kanë pas internatit, janë ushqyer atje. Nuk ka qenë keq për ta, por unë kur i shifsha diçka më u dhimbshin shumë. Disa nxënës kanë pas mirë, kanë qenë të kontrolluar nga ana e OZNAs³ kanë qenë njerëz të caktuar që kanë përcjellë nxënësit si po veprojnë. Bash në atë klasë ku kam qenë unë kujdestare e klasës, kanë qenë një dy vetë të cilët shpesh janë marrë në biseda të tjera, edhe janë maltretuar. Jam angazhuar me i ndihmu, normalisht unë vetë s'kam mujtë, nëpërmjet Fadilit jam angazhuar, me intervenuar që të mos sillen qashtu. Në qat mënyrë jam përpjekë me i ndihmu. Prandaj, noshta edhe i kom lonë një përshtypje të mirë atyre nxënësve.

Antigona Qena Kaçaniku: Mandej fillon Prishtina të lulëzojë kultura, shkollimi, rinia...

Vahide Hoxha: Ah, po qysh jo...

Antigona Qena Kaçaniku: Unë kam qenë një kohë bukur të gjatë, kryetare e Bashkësisë së Kulturës. Bashkësia e Kulturës në një periudhë '70-shin, '72-shin, '73-shin, buxheti i Kosovës ka pasë të holla pak ma shumë se sa... Se përqindja për vendet e pazhvilluar u rritë pak ma tepër, edhe për kulturë e ndanë ma shumë. Më me të thanë qat' periudhë bashkë me qata shokë që kemi punuar bashkë, në atë periudhë janë vu temelet dhe janë ndërtuar biblioteka, arhivi, shpila e kulturës në Serbicë, shpila e kulturës në Pejë, në Gjakovë, në Kaçanik, në Podujevë dhe shpila e fizikulturës në këto vende janë ndërtuar në qat' periudhë. Nuk kemi më me ndërtuar në Prizren për shembull, shpila e kulturës, që ka më hala ashtu se nuk kanë qenë aktiv me gjetë trolin se ku me ndërtuar, s'ka qenë puna e pareve. Nuk ka qenë puna e angazhimit tonë, jemi angazhuar. Nuk kemi mujtë me ndërtuar Operën në Prishtinë, gjithashtu ka qenë puna e trolit. Në këtë periudhë edhe botimi i librave ka qenë më i madh. Asht ndërtuar... unë harrova me cekë, asht ndërtuar edhe Qendra e Filmit në atë periudhë, Qendra e Filmit, edhe kemi pasë bukur do filma të mira, me artistë të mirë. Sa i përket asaj kohe, çdo shfaqje teatrale që ka dhanë Teatri Krahinor, s'kemi lanë, kur kemi qëlluar këtu normalisht edhe kemi pak mundësi.

Kolegiumi Kantorini, korr asht zhvilluar. Kemi pasë korrin të mrekullshëm, pastaj kemi pasë edhe Akordet. E ato Akordet kanë qenë në nivel mjaft të ultë. Unë nuk e di pse nuk e vazhduar ato Akordet edhe shpesh po përpiqen disa objekteve me i dhanë fillimin e punës prej kësaj periudhe që po hupin historinë e vetë. Hupe historinë, hupe jetën, hupe atë vehten e hupe, qytetnimin e hupe, zhvillimin kulturor tandin e hupe.

Antigona Qena Kaçaniku: Ju jeni edhe në këtë kohë shumë aktive?

³ Titulli i plotë në serbisht *Odjeljenje za zaštitu naroda*, apo në shqip *Njësia për mbrojtjen e kombit* - shërbim jugosllav i sigurimit. OZNA ishte sikur çfarëdo organizatë tjetër e sigurimit e shteteve socialiste të themeluara për të shpiunuar popullatën duke përdorur një rrjet informantësh dhe duke luftuar çfarëdo opozite me mjete të hapura dhe të fshehta.

Vahide Hoxha: Po Antigona, kam vu detyrë prej fillimit noshta që nëse mes në shpi vetëm t'pastroj, e të fshij pluhnat, e të zij, të cilat punë po i boj edhe tashti, kërkush tjetër nuk m'i ban. Përpos ktyne punëve t'shpisë, i kam vu detyrë vetes qi po nejta në shpi, une ndryshkem. Sidomos masi vdiq Fadili unë nuk kam mujt me leju vetes, megjithëse atë e kam përpara gjithmonë. A natë, a ditë, a gjum a pagjum e kam, por kam dashtë pakëz me e ndërru situatën, mos t'mendoj vetëm në të dhe t'mos mendoj në fëmijtë, ku janë e tek janë e tjera.

Unë fillova me vizatu edhe deri sa ka qenë gjallë Fadili, po s'e di edhe pse kam fillu' me t'kallëzu t'drejtën s'di. Veç e kam marrë do lapsa, do sende, do ngjyra edhe fillova andej këndeje e pashë që diçka po shkon mirë edhe fillova. Më këshillonte Fadili, "Po mos e lodh veten, po lodhesh! S'e di a ka me t'dalë diçka mirë, a jo" (qeshë). Kurgja... unë e bana ekspozitën e parë edhe i kam fotografitë prej ekspozitës t'parë edhe inçizimin, edhe Fadili aty, edhe Ramiz Kelmendi pat qenë. Edhe do fjalë të mira Ramiz Kelmendi...

Kështu fillova une, dalë ngadalë bana një ekspozitë këtu në Prishtinë. Pastaj bana një ekspozitë kur qe dy vjetori i Fadilit i vdekjes në Gjakovë. Une shënova me ekspozitën time dy vjetorin e vdekjes së tij. Prej Gjakovës, e bana ekspozitën në Prizren, deshta në Prizren Hamamin me shfrytëzu. E kjo e treta edhe këtu një në Bibliotekë aty; edhe një vjet, a kur e pata, në Institutin Albanologjik, kështu që sa për mu, boll! Pikturat i kam shpërnda, e nipat edhe mesat secili e ka zgjedhë atë që po i pëlqen. Kshtu që kam vendosë atyne me ju dhanë shumicën. Jam kryetare e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Kjo asht shoqatë e luftëtarëve të Luftës së Dytë Botnore, aty jam kryetare edhe angazhimi i jonë është qi t'mbrojmë vlerat nga Lufta Nacional-Çlirimtare.

Neve kemi ba bukur do punë, e kemi qitë disa libra, kemi organizu tubimet përkujtimore me rastin e vjetorit të këtyne udhëheqësve që janë. Kshtu që jemi angazhu për përmendoret nga Lufta e Dytë Botnore, megjithëse përmendoret po na i rënojnë, po i rrëzojnë edhe... Gjashtë vjet kemi punu, vetë kemi pagu kafet, vetë kemi pagu telefonin. Edhe mundesh me marrë me mend pensionet tona sa janë, por nuk kemi dashtë me u dorëzu. Jo Vahidja vetëm jo, bashkë me shokët aty që jonë... luftëtarëve, nuk kemi dashtë me u dorëzu edhe vazhdojmë edhe ma tutje sa t'mundemi. Sa jemi gjallë neve, secili prej nesh... ma i vjetri i ka 89 vjet (qeshë). Une 86 vjet, ai tjetri 84, kështu qi jemi n'moshë që çdo ditë presim që... {lëvizë duart}.

Antigona Qena Kaçaniku: Më lejoni që s'paku këtë emision t'vogël të ju falem'nderoj për guximin, për vullnetin, idealet e një femne e cila i ka kalu edhe t'mirat edhe t'kqijat, po ka frymu në këtë vend në këtë nënqiell. Ju falemnderit që keni qenë dhe jeni!

Vahide Hoxha: Nuk di a ka mujtë me dhanë qato kryesoret që asht dashtë me spjegu, por qaq sa mujta!

Antigona Qena Kaçaniku: Falem'nderit shumë.

Rrëfimi është i sinqertë, modest, njerëzor – ashtu çfarë është edhe kjo zonjë që ndonëse në moshë të shtyer, ende ka forcën e e zemrën e një vajze të re përplot mirësi e dëshirë që i jep krahë të vërtetës, të drejtës, të ardhmes.

U ndamë nga zonja Vahide dhe të vetëdijshëm që nuk mujmë t'i shpalojmë të gjitha fletët e një libri jetësor. Historiane me profesion u bë vetë historia e cila një ditë me siguri do të shkruhet ashtu siç e meriton e vërteta – pa zbukurime dhe pa njolla e lëndime.